REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr.2691 Prot

Maliq, më 04.05.2026

VENDIM
Nr. 50 datë 30.04.2026

"Për miratimin e rendit të ditës të mbledhjes së datës 30.04.2026 të Këshillit të Bashkisë Maliq"

Në zbatim të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"* i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma "b", neni 53 pika 3, neni 54 gërma "k" si dhe nenit 66, pika 11 e Rregullores të fuksionimit të Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, Këshilli i Bashkisë Maliq,

VENDOSI:

1.Të miratojë rendin e ditës për mbledhjen e Këshillit të Bashkisë Maliq, të datës 30.04.2026 me ndryshimet e propozuara dhe njoftimit bashkangjitur.

2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar me 16 vota
Vota Pro 16
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 04.05.2026

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr2530/1 Prot. Maliq, më 24.04.2026

NJOFTIM

LËNDA: Mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Maliq

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ
KRYETARIT TË BASHKISË MALIQ

Të nderuar,

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* datë 17.12.2015, i ndryshuar, neni 53, *"Funksionimi i këshillit bashkiak"*, pika 2, pika 4 dhe 5, neni 56 *"Kryetari i këshillit bashkiak"* pika 2 gërma "a", dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, *"Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq"* ju njoftojmë se mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Maliq do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të këshillit ditën e enjte**, më datë 30.04.2026**, **ora 10:00** me këtë,

Rend Dite :

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar datë (27.03.2026)
4.P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin mars 2026";
5.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë"
6.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familjen e z.F.XH banuese në FshatinVelitërnë Nj.A Pirg, banesa e të cilës u dogj si shkak i rënies të zjarrit";
7.P-V "Për një ndryshim në buxhetin e bashkisë Maliq për vitin 2026";
8-P-V "Për përdorimin e fondit për mbrojtjen civile nga buxheti i shtetit";
9.P-V "Për lehtësimin e përkohëshëm nga detyrimi për pagesën e taksës së tokës bujqësore për familjet bujqësore, toka e të cilave është e përmbytur dhe e pamundur për t'u shfrytëzuar gjatë vitit bujqësor 2026 nga dëmtimet e forcave madhore të natyrës";
10.P-V "Për miratimin e përfituesve nga programi subvencioni i interesave të kredisë për strehim";
11. Analiza e zbatimit të buxhetit të bashkisë Maliq për vitin 2025.
12.Njoftim për inventarizimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të bashkisë Maliq viti 2025.
13.Diskutime të tjera.

Shënim: Mbledhjet e Komisioneve të Këshillit do të mbahen ditën e martë me datë 28.04.2026 nga ora 10:00-13:00 si më poshtë:

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut. Pikat 4, 5 të rendit të ditës:
z.Faslli Zholli, znj.Gentiana Drabo, z.Armando Dautllari, z.Plator Çollaku, znj.Marjeta Xhelollari

Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit. Pika 6, e rendit të ditës: z.Dritan Çami, znj.Floreta Zaçe, z.Ilia Xhuti, z.Almir Elezi, z.Yllson Ibrahimllari

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare. Pikat 7, 8, 9 të rendit të ditës: z.Petrit Kupe, znj.Pranvera Begolli, znj.Marianthi Avrami, znj.Eglantina Balli, z.Andonaq Risto.

Komisioni i Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimit. Pika 10 e rendit të ditës:z.Idlir Limllari, z.Selami Muço, znj.Pranvera Begolli, z.Almir Elezi, z.Faslli Zholi.

Ju faleminderit!

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ